



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
02.07.2021

Me datë 02.07.2021, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Bledianë Nika, Nersada Mandija, Aurora Dibra, Diana Muriqi, Tereze Brigja, Age Martini, Sabina Danaj, Erion Metushi, Sead Çoçja, Sokol Zaimaj, Vjollca Petani, Sabahet Lishi, Suada Selimaj, Donika Ndoja, Kristi Shllaku, Suada Selimaj, Lumnije Guri, Arvit Osja, Anton Kaftalli, Hilmi Lakti, Gerald Hasaj, Besmir Vukaj, Anton Deda, Blerim Dimnaku, Gjergj Sokoli, Andi Hallunaj, Luigj Palushi, Arbis Vjerdha, Lindita Nika.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim *“Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares bashkiake znj. Jetmira Rraboshta”*
2. Pr/ Vendim *“Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Maj 2020”*
3. Pr/Vendim *“Për një ndryshim në VKB nr.11 dt.9.4.2016 për miratimin e disa linjave të rregullta rrethqytetase të transportit të udhëtarëve”*
4. Pr/Vendim: *“Për një ndryshim në VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër” (nr. i punonjësve)*
5. Pr/ Vendim *“Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 për Bashkinë Shkodër”*
6. Pr/Vendim: *“Për një shtesë në VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar*

7. Diskutime jashtë rendit të ditës

Rendi i ditës u votua me propozimin e Kryetares së Këshillit për shtyrje të pikës 5 të rendit të ditës Pr/ Vendim *“Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 për Bashkinë Shkodër”*

Me 28 vota Pro, rendi i ditës miratohet

1. Mbledhja vijon me Pr/Vendimin *“Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares bashkiake znj.Jetmira Rraboshta”* Relaton znj.Diana Murici. Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

2. Mbledhja vijon me projektvendimin *“Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Mars 2020”*. Fjalën e merr Z.Arbi Vjerdha, i cili propozon që miratimi i këtij Pr/Vendimi të bëhet për të mos pasur vonesa, automatikisht pa qenë nevoja të mblidhet K.Bashkia. Znj.Kryetare e Këshillit thotë që kjo gjë duhet të diskutohet nga Komisioni dhe administrata dhe të ketë një përgjigje për këtë në mbledhjen e ardhshme.

Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

3. Mbledhja vijon me projektvendimin *“Për një ndryshim në VKB nr.11 dt.09.04.2016 për miratimin e disa linjave të rregullta rrethqytetase të transportit të udhëtarëve”*. Fjalën e jepet Z.Vildan Broja, përfaqësues i Bashkisë, i cili shpreh që duke u nisur nga problematikat e zonës turistike është parë e arsyeshme që shtohet dhe një sens tjetër rrugë. Fjalën e merr znj.Selimi, e cila do të dijë a do jete e aksesueshme kjo rrugë gjatë gjithë vitit. Z.Broja thotë që kjo gjë nuk mund të jetë përgjegjësi e tij. Me tej fjalën e merr znj.Brixha, e cila kërkon të dijë diçka më shumë mbi pikat e nisjes së automjeteve. P.sh: transporti i mesuesve dhe nxenesve. Po ashtu edhe znj.Nika kërkon zgjidhje për këtë problem, duke pasur parasysh që ekzistojnë fasha oraresh, që duhen respektuar. Z.Broja, thotë, që një zgjidhje perfekte nuk është gjetur nga asnjë bashki. Kjo është parë si mundësia më e mirë, duke i vendosur pikat e nisjes në periferi, duke mos penguar qarkullimin në qytet. Megjithatë ai është i gatshëm për çdo ide dhe bashkëpunim. Në emër të grupeve të kryetarëve znj.Dibra dhe z.Sokoli shprehen pro.

Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

4.Mbledhja vijon me projektvendimin “Për një ndryshim në VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër”.(nr.i punonjësve)

Fjalën e ka Kryetarja e Keshillit cila thote qe ky projekt Vendim eshte relatuar ne mbledhjen e kaluar nga Kryetarja e Bashkise.Eshte shtyre vendimmarrja sepse eshte kërkuar nga sekretariati i Keshillit nje punonjës shtese dhe kërkesa e grupit te keshilltareve eshte realizuar me vendim te Kryetares se bashkise.Kryetaret e grupeve shprehen pro. Hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 1 Kundër, 1 Abstenim.

Miratohet

5. Mbledhja vijon me projektvendimin “Për një shtesë në VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar. Fjalën e ka Kryetarja e Keshillit,e cila thote qe Cmimi i dhene nga Bashkite e forta per Keshillin Bashkiak te Shkodres,me vlere 5000€,kalon ne buxhetin e Bashkise.

Keshilli propozon qe vlere prej 200.000 mije lekesh e këtij fondi te perdoret si ndihme financiare per mjeshterin e madh z.Kujtim Alija.Ky fond do jepet sipas programit 09120.

Dhe vlere prej 100.000 mije lekesh t’i kaloje familjes se te ndjerit Musein Zeneli,qe humbi jeten ne ngjarjen e ndodhur ne Velipoje.Fondi i akordohet sipas programit 10430.

Vlora e mbetur do kaloje ne programin buxhetor nr.01110 te Bashkise (Planifikim,menaxhim dhe administrim,mbështetje per organet e zgjedhura vendore.Ekspertize dhe konsulence per Keshillin bashkiak).

Fjalën e merr Z.Vjerdha,i cili shprehet qe eshte plotësisht dakort me dy te paret,por persa i perket çmimit per K.bashkiak,ai mendon qe ky këshill eshte i vetmi qe ka miratuar vetem nje nga rregulloret e tij.

Pason Z.Selimi,i cili shpreh dakortesi per fondet qe do jepen per bamirësi,por ka paqartësi per përdorimin e pjeses se mbetur te çmimit.

Kryetarja sqaron se përdorimi i pjeses se mbetur do vendoset me vendimmarrjen e anetareve te Keshillit Bashkiak.

Z.Metushi mendon te hidhet ne votim menjehere.Fjalën e merr Z.Kaftalli,qe thote se nuk duhet te ishte pritur deri tani per nje ndihme financiare per mjeshterin K.Alija,Duke patur parasysh vlerat qe ka Z.Alija per qytetin e Shkodres.

Vazhdon Nen/K. i bashkise,i cili thekson qe ky eshte nje financim modest brenda mundësive financiare te bashkise,duke qene te vetedijshem per vlerat e mjeshtrit Alija.Por nuk duhet gjykuar gabim per mundesite e pakta te fondeve te bashkise.

Merret mendimi i kryetareve te grupeve,te cilet jane plotësisht dakort.

Hidhet në votim, ku rezultojnë 30 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

6.Vazhdohet me diskutime jashte rendit te dites.Fjalën e merr Z.Kaftalli,i cili deshiron te dije rreth procedurave te rekrutimit te drejtorit te ri te teatrit “Migjeni”,meqenëse drejtoresha ne detyre eshte ne prag daljeje ne pension.

Vazhdon Z.Zaimaj,i cili kërkon ndërhyrjen e bashkise per nje shqetësim ne lidhje me vendosjen e nje stufe ne nje klase per nxenesit me aftesi ndryshe ne shkollen e tij.

Fjala i jepet Z.Vjerdha,i cili thekson qe nuk ka nje përgjigje persa i perket kerkeses se tij ne lidhje me rregulloret e brendshme te drejtorive te bashkise.

Merr fjalen Znj.Petani,e cila shpreh kerkese te perseritur per Z.Filip Vila,i cili akoma nuk ka gjetur zgjidhje per qente e rruges,te cilet vazhdojne te jene imazh i shemtuar per qytetin dhe burim infeksionesh.Po ashtu ajo kërkon shpjegim per kiosken portokalli ne pedonale e qytetit.Z.Vjerdha shpreh dakortesi te plote.

Fjalen e merr Z.Vukaj,i cili kërkon te dije pse kioska nuk eshte hequr,përderisa eshte marre nje vendim nga këshilli bashkiak per te.

Fjalen e merr Nen/Kr.i bashkise z.Tonin Dedaj i cili sqaron mosprezencen e Kryetares se Bashkise,per shkak te nje angazhimi te rendesishem.Persa i perket pyetjeve dhe shqetësimeve te anetareve ai kërkon kohe dhe mirëkuptim .meqenese sapo ka marr detyren dhe premtion ne përgjigje me shkrim si dhe verbale ne mbledhjen e ardhshme te këshillit.

Z.Kryetare e Keshillit,deklaron te mbyllur mbledhjen.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 2.7.2021. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio (DVD)

Procesverbali përmban 4 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESHJA

KRYETARE

Drisela KADIJA